



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2021:287400

Datë: 24.09.2024

Numri i dokumentit: 06199196

K.DH.Shk II.nr.141/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Ramush Bardiqi në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania Rajonale e Ujësjetllësit “Gjakova” SH.A, Dega në Gjakovë, NRB 70433554, Rr. “UCK”, nr.7, kundër debitorit “Telekomi – Drejtoria –Nëna Terezë, Gjakovë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.758/22 të datës 28.07.2023, me datë 23.09.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit Kompania Rajonale e Ujësjetllësit “Gjakova” SH.A, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.758/22 të datës 28.07.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.758/22 të datës 28.07.2023, në dispozitivin e aktvendimit e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit “Telekomi – Drejtoria –Nëna Terezë, Gjakovë i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.743/21 të datës 26.11.2021, lejuar nga Përmbartuesi Privat Gjokë Radi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, (me pretendime sikur në ankesë), me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.758/22 të datës 28.07.2023.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e të kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Kompania Rajonale e Ujësjetllësit “Gjakova” SH.A, Dega në Gjakovë, ka paraqitur propozim për përmbartim në bazë të dokumentit të besueshëm – Ekstraktit nga Librat e Kontabilitetit i datës 01.11.2021 me të cilin ka detyruar debitorin Telekom – Drejtoria – Nëna Terezë Gjakovë, për pagesën e borxhit kryesor prej 3,080.59 Euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga data e propozimit për përmbartim e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës së përmbartimit që do të krijohen prej momentit të këtij propozimi.

Debitori, Telekom i Kosovës SHA – Prishtinë, në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor duke theksuar se urdhri përmbartimor nuk mund të ekzekutohet dhe se nuk është i përmbartueshëm, përkatësisht se dokumentet e bashkangjitura nuk e kanë cilësinë e dokumentit të besueshëm siç përcakton neni 29.3 i LPP-së, pasi që nuk janë të bashkangjitura ekstraktet origjinale e as kopja e vërtetuar andaj nuk e kanë cilësinë e përmbartueshmërisë konform dispozitës së nenit 38.1 dhe 38.2 të LPP-së. Shton se së pari është dashtë të dorëzohen faturat individuale veç e veç dhe pastaj këto fatura të pranuar, të nënshkuara dhe të protokolluara nga ana e debitorit do të mund të konsiderohen dokumente të besueshme. Tutje shton se ekstrakti nuk i përmban elementet e përcaktuara sipas LPP-së pasi që përmban vetëm emrin dhe mbiemrin por jo edhe nënshkrimin e debitorit dhe se nuk është faturë kthyesë. Po ashtu thekson se kemi periudhë të gjatë kohore dhe ka konfuzitet në kërkesa për pikëpamje kohore gjë e cila e tregon parashkrimin dhe vjetërsimin e kërkesave të kreditorit për pjesën më të madhe të borxhit prej 36 muajve rrjedhë se ato janë vjetërsuar në kuptim të përcaktimit ligjorë dhe kërkon që këto fakte të vlerësohen nga Gjykata sipas detyrës zyrtare. Tutje thekson se emri i debitorit në urdhrin përmbartimor nuk korrespondon me emrin dhe selinë e Telekomit të Kosovës SH.A e cila ka emër dhe adresë tjetër në certifikatën e biznesit. Përfundimisht thekson se me datën 1.12.2021 ka kryer pagesën e përsëritshme të borxhit në vlerë prej 2,561.87 euro që vlerësohet nga dokumentacioni i transferit bankar dhe duke ndikuar se diferenca e borxhit në vlerë prej 518.72 Euro është diskutabile dhe tërësisht jo reale. Andaj ka kërkuar nga gjykata të pranoj prapësimin dhe anulon urdhrin përmbartimor.

Kreditori, në përgjigje ne prapësim i kundërshtoi pretendimet e debitorit se ekstrakti i verifikuar nga librat afarist nuk është dokument përmbartimor dhe se nuk është i përshtatshëm për përmbartim. Po ashtu njofton se kërkesa i referohet periudhës 01.10.2009 deri 01.11.2021 dhe jo siç pretendon debitori nga viti 2003. Lidhur me pretendimet e debitorit për parashkrimin e kërkesës i referohet neni 368 të LMD-së duke sqaruar se pagesa e debitorit në vlerë prej 904.59 euro ka ndërpre afatin e parashkrimit. Ndërsa pagesat e bëra me dt.01.12.2021, në vlerë prej 2,561.87 euro është për të gjitha kyçet të cilat kemi me kontratë me Telekomin ku vlera prej

904.54 euro, hyn në vlerën totale prej 2.561.87 euro. Në përgjigje po ashtu kërkoi precizimin e vlerës totale sipas Propozimit për përmbarrim nga vlera 3,080.59 euro të precizohet tani në 2176 euro. Përfundimisht duke cituar nenin 355 të LMD-së kërkoi të refuzohet prapësimi si i pabazuar dhe si provë parashtrori vendimin e Gjykatës Themelore Gjakovë-Dega në Rahovec për të mbështetur pretendimet lidhur me ndërprerjen e parashkrimit si rrjedhojë e pagesës nga debitori.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.758/22 datës 28.07.2022 e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit “ Telekomi – Drejtoria –Nëna Terezë, Gjakovë i paraqitur kundër Urdhrit Përmbarrimor P.nr.743/21 të datës 26.11.2021, lejuar nga Përmbarruesi Privat Gjokë Radi. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka vlerësuar se propozimi nuk i përmban elementet e përcaktuara në nenin 37 dhe 38 par. 1 të LPP-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarrimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se në bazë të Ekstraktit nga Librat e Kontabilitetit në të cilin mungon numri identifikues, debitori është i evidentuar vetëm si Telekomi Drejtoria dhe nuk përmban numër identifikues apo të biznesit, ndërsa ne propozim është i evidentuar si Telekomi – Drejtoria – Nena Terezë- Gjakovë. Nga shkresat e lëndës dhe me shikim në të dhentat e ARBK-së, evidentohet debitori si Telekomi i Kosovës SH.A me numër unik identifikues 811288001. andaj,,në mungesë të dhënave të sakta lidhur me biznesin është aprovuar urdhri përmbarrimor sepse edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate përmbarruesi privat nuk ka vepruar konform nenit 38 par 2 i LPP-së, ashtu që ti kthej kreditorit propozimin për plotësim.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim ne pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykate i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata vlerësoj pretendimet ankimore të kreditorit se mirëpo me propozimi për përmbarrim në bazë të së cilit është lejuar urdhri për përmbarrim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 38 të LPP-së., vendosi që aktvendimin e ankimuar ta vërtetoj.

Përndryshe në procedurën përmbarrimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarrimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarrues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarrimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e shkallës së dytë
K. DH.Shk II.nr. 141/24 , Datë 23.09.2024

Gjyqtari,
Ramush Bardiqi